




Republika e Kosovës



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/24 Nr. i faq./Br.str./No.pg 76

Data/Daturn/Date 28 03 / 2025

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr. 08/L-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 202, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.03.2025 miraton këtë:

V E N D I M

Për bartjen dhe tejkalimin e të hyrave vetanake nga viti 2023-2024 të barten në vitin 2025

1. **Miratohet vendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2023 dhe tejkalimin e planifikimit e të hyrave vetanake nga viti 2024, mjetet të barten në vitin 2025 në shumë prej 679,543.24€ (gjashtë qind e shtatë dhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katërdhjetë e tri euro e njëzet e katër cent)**
2. Mjetet në shumën prej 596,264.17€ (pesë qind e nëntë dhjetë e gjashtë mijë e dy qind e gjashtë dhjetë e katër qind euro e shtatë mbëdhjetë cent) nga fondi burimore (21) do të barten në vitin 2025 në këto programe dhe kategori buxhetore si në vijim:

- Në fondin Burimor (21) në kategorinë e investimeve kapitale në shumë prej 579,543.24€:

2.1. Në programin Administrata dhe Personeli (163), nën programi Administrata (16311), kodi funksional (0133)

2.1.1. Rregullimi i objektit të gjendjes civile (Objekti i Zjarrfiksëve në Rahovec) në shumë prej: 30,000.00€:

2.2 Në programin Buxhet dhe Financa (175), nën programi Buxhetimi (17511), kodi funksional (0112)

2.2.1 Projekte me bashkëfinancim, kodi (53782), në shumë prej 60,000.00€,

2.3. Në programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).

2.3.1 Ndërtimi rrugëve Rahovec-Xerxe-Opterushë-Krushë Madhe-Gexhe-Kramovik-Hoqë, kodi i prejktit (53790) në shumë prej 60,000.00€;

2.4. Në programin Zyra Lokale për Komunitete dhe Kthim (195), nën programin Zyra Lokale për Komunitete dhe Kthim (19555), kodi funksional (1090).

2.4.1 Ndërtimi dhe Rregullimi i rrugëve për komunitete jo shumicë Rahovec, Hoqë e Madhe, Xerxe, Ratkoc, Krushe e Madhe, kodi (53781), shumë prej 25,743.24€

2.5 Në programin Planifimi Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66360), kodi funksional (0620).

2.5.1. Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit, kodi (49832) në shumën prej 50,000.00€;

2.5.2 Ndërtimi i Qendrës Përkujtimore të UÇK-së në Retijë, kodi (55805) në shumë prej 50,000.00€

2.6 Në programin Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730) nën programi Shërbimet e shëndetësisë primare (73700), kodi funksional (0721)

2.6.1 Ndërtimi dhe Renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve (Ratkoc, Krushe e Madhe, Fortesë, Xërxe, Drenoc), kodi (52281) në shumë prej 38,800.00€

2.7 Në programin Kulturë, Rini, Sport (850), nën Shërbimet Kulturore – Rahovec (85011), kodi funksional (0820).

2.7.1 Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec, kodi (48175) në shumën prej 75,000.00€;

2.7.2 Ndërtimi i infrastruktures për aktivitete kulturore në Dejnë dhe sipas prioriteteve, kodi (49943), në shumën prej 30,000.00€

2.7.3 Rregullimi i tereneve sportive Xërxe, Pataqan-Nashpall, Fortesë, Krushë e Madhe, kodi (53798), në shumë prej 50,000.00€

2.7.4 Riparimi monumenteve kulturore Krushë Madhe, Hoqë Vogël, Rahovec, kodi (53799) në shumë prej 55,000.00€

2.8 Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93300), kodi funksional (0912)

2.8.1. Renovimet ne shkollat Haki Stermilli Zoqisht, Skender Kastrati Gexhe, Gezim Hamza Piktori Rahovec, Rudolf Ëalthër Dobidol, Vellezerit Frasheri Senoc, deshmoret e Zatriqit 12 Maji Ratkoc, Xhelal Hajda-Toni kodi (55185) në shumën prej 55,000.00€;

3. Nga fondi burimor (21) në kategorinë Mallerave dhe Shërbimet në shumë prej 16,720.93 €.

3.1 Në programin Kadastra dhe Gjeodezia (650), nën programi Shërbimet Kadastrale (65055), kodi funksional (0650) në shumë prej 16,720.93€.

- Nga fondi Burimor (22) shuma prej 83,279.07 €

4. Nga fondi Burimor (22) në kategorinë Mallerave dhe Shërbimet në shumë prej 33,279.07€:

4.1 Në programin Kadastra dhe Gjeodezia (650), nën programi Shërbimet Kadastrale (65055), kodi funksional (0650) në shumë prej 33,279.07€.

5. Nga fondi burimor (22) në kategorinë e Subvencionet dhe Transferet në shumë prej 50,000.00€.

5.1 Në programin Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi (470), nën programin Bujqësia (47011), kodi funksional (0421) në shumë prej 50,000.00€.

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.24/24
Datë: 28.03.2025

